

**URDHËR**  
**Nr.224, datë 25.5.2012**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 8046, DATË 2.12.2004 “PËR KUSHTET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJË NJË ZYRË NOTERIALE PËR TË MUNDËSUAR USHTRIMIN NORMAL TË VEPRIMTARISË SË NOTERIT”**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar, dhe paragrafit 3 të nenit 12 të ligjit nr. 7829, datë 1.6.1994 “Për noterinë”, të ndryshuar,

**URDHËROJ:**

I. Në urdhrin nr. 8046, datë 2.12.2004 “Për kushtet minimale që duhet të plotësojë një zyrë noteriale për të mundësuar ushtrimin normal të veprimtarisë së noterit”, pika 10 ndryshohet si më poshtë:

“10. Zyra duhet të jetë e pajisur:

a) me ndriçim të mjaftueshëm;

b) me kompjuter i cili duhet të ketë karakteristikat minimale sipas aneksit nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri si dhe elemente të tjera ndihmëse, shërbim interneti 24 orë dhe llogari elektronike identifikuese, e cila përmban të dhëna mbi *username*, *password* dhe nënshkrim (të dhënat e shenjave të gishtit), me qëllim realizimin e aksesimit në sistemin elektronik të pasurive të paluajtshme;

c) me tavolinë të përshtatshme;

ç) me ndenjësë;

d) me raftë për mbajtjen e dokumentacionit arkivor dhe regjistrave dhe kur është e mundur;

dh) me kasafortë; dhe

e) me pajisje të tjera komunikimi (telefon, faks, fotokopje), të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre.”.

II. Ngarkohen noterët dhe strukturat përgjegjëse për veprimtarinë e noterisë në Ministrinë e Drejtësisë, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI I DREJTËSISË**  
**Eduard Halimi**

**ANEKSI NR.1**

1. PC, me këto karakteristikat minimale:

- Min RAM 512, Pentium III

- Internet Browser: Internet Explorer, Mozilla Firefox or Google Chrome

- usb 2 ports

- OS: Windows XP ose Windows 7 32 bit